



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik
-Shërbimi i Kuvendit-

01Nr. 60/01-37747/2018
Kaçanik, 29.11. 2018

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **XI (Njëmbëdhjetë)** e Rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik (Legjislatura e VI-të), mbajtur me, 29 Nëntor 2018. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës, prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin 27 anëtarë- të gjithë.

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës- Besim Ilazi, drejtorët e drejtorive komunale (Ukshin Qallaku, Festim Neziraj, Zahir Doda, Fatmir Loku, Ramadush Osmani dhe Bahri Selimi), ndërkaq nga zyrtarët komunal ishin: Bejtullah Dalloshi dhe Arbnora Kuka.

Nga OSBE, mbledhja u monitorua nga, Gazmend Mërseli.

Nga cilësi të qytetarëve të komunës, në mbledhje mori pjesë: Artan Mezraja dhe Bukurie Sopa.

Mbledhja u monitorua përmes Teleprezencës nga Gëzim Sahiti, Zyrtar i lartë për monitorimin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në MAPL.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,
Procesmbajtës, Makfir Malsiu, Zyrtarë e Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari iu përshëndeti të gjithëve, iu uroj mirëseardhje, në vazhdim e lexoj listën e anëtarëve të KK emër për emër, kuorumi ekziston, kështu e hapi mbledhjen e XI (Njëmbëdhjetë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2018, data 29 Nëntor, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Propozim Rregullorja për Tatimin për pronën e paluajtshme për vitin 2019;
3. Raporti Financiar për periudhën: Janar- Shtator 2018;
4. Propozim Vendimi për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal; dhe
5. Plani lokal i veprimt për persona me aftësi të kufizuara në komunën e Kaçanikut, 2019-2021.

Rendi i propozuar i punës u shtrua në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës,

APROVOJ

Rendi i Punës në përbërje prej 5 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas radhës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

Procesverbali i mbledhjes së 10 -të e Rregullt i Kuvendit të Komunës u aprovua njëzëri pa vërejtje. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës, e;

APROVOJ

Procesverbalin nga mbledhja e 10 (Dhjetë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës të datës 30 Tetor 2018. / Lënda 01Nr. 60/01-34743/2018

Para se me kaluar në pozicionin e pyetjeve dhe Kërkesave, Kryesuesi i Kuvendit e njoftoj KK lidhur me një Vendim të Kuvendit të Komunës për ndërrimin e destinimit të parcelës kadastrale nr.516-I, Zona Kadastrale në Kaçanik, i cili vendim është kthyer nga MAPL, si i kundërligjshëm. Ne i kemi zbatuar të gjitha procedurat ligjore ashtu që Vendimi është dërguar në MAPL me 3 Tetor, nga ajo datë kemi pritur 15 ditë ligjshmërinë nga MAPL, por nuk kemi pasur ndonjë konfirmim. Me datë 19 Tetor Vendimi është publikuar në Faqen Zyrtare të Komunës, ndërkaq nga data e publikimit Vendimet e KK hynë në fuqi 7 ditë pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës, ndërkaq nga MAPL na është kthyer vendimin e kundërligjshëm me 26 Tetor 2018, d.m.th. një ditë pasi ka hyrë në fuqi vendimi, ndërkaq vendimi ka hyrë në fuqi me datë 25 Tetor. Për këtë është njoftuar edhe ekzekutivi i komunës dhe ne kemi vlerësuar se jemi në rregull sa i përket procedurave ligjore dhe vendimi ka filluar me u zbatuar. Kjo është sa për njoftimin e juaj, ndërkaq iu njoftoj së Kërkesë nga MAPL për shfuqizim të vendimit në fjalë nuk kemi. Nëse dikujt i intereson më tepër, mundemi me ua dhënë shkresat e MAPL. Fjala është për vendimin që është lejuar me iu ndërruar destinimi pronës në ZK në Kaçanik, për ndërtimin e objektit të ETC-së.

Në vazhdim Kryesuesi i Kuvendit, konstatoj me kaluar në pozicionin e Pyetjeve dhe Kërkesave:

Pyetje dhe Kërkesa

z. Ekrem Kyçyku, Fillimisht shfrytëzoj rastin t'iu uroj festat e Nëntorit, ndërkaq shprehi shqetësime lidhur me shkatërrimin e pyjeve në Komunën e Kaçanikut, shqetësim ky i ngritur edhe në mbledhjen e kaluar, për të cilën kemi marrë një përgjigje nga shërbimi përkatës profesional. Për këtë çështje, në emër të LVV kërkojmë t'iu bëjmë një Kërkesë nivelit qendror- ministrisë përkatëse, për me marrë masa urgjente për me u shpëtuar pyjet e Komunës së Kaçanikut nga shkatërrimet dhe degradimet. Besoj së kjo kërkesë e LVV do të përkrahet nga të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës.

z. Adnan Reka, Fillimisht shfrytëzoj rastin t'iu uroj festat e Nëntorit, ndërkaq Pyetja është për drejtorin e DSHPE; A nënkupton se edhe sanimi i rrugës "Qamil Ilazi" me saktë, para 'Veli Kovaçit' (ajo gropa e madhe), dhe kanalizimi i ujerave të zeza afër hyrjes së Xhamisë, e që nuk kalon javë dhe të mos rrjedh përmes qytetit, do te ndodhë vetëm atëherë kur të përfundoj Plani i detajuar nga DSHPE dhe DUKMM në bulevardin 'Ismajl Raka' dhe

rrugën 'Qamil Ilazi'. A do të thotë kjo që së paku edhe një vit do të detyrohemi të ecim nëpër kanalizim dhe nëpër baltë?

z. Bekim Koxha, Fillimisht shfrytëzoj rastin t'iu uroj festat e Nëntorit, ndërkaq për çështjen e prerjes dhe dëmtimit të pyjeve, unë kam marrë një përgjigje nga DBPZHR, ndërkaq nuk jam i kënaqur me atë përgjigje. Gjendja e pyjeve është alarmante, ndërkaq nuk është duke u marrë asnjë veprim nga organet kompetente. Pavarësisht së është Zonë e mbrojtur ajo pjesë, kujtoj se drejtori i DBPZHR dhe ekzekutivi i komunës në përgjithësi si duket nuk janë duke marrë asnjë veprim në këtë drejtim.

znj. Nazife Krasniqi,

1. Në emër të Komitetit për Komunitete shprehi shqetësime lidhur me një mbledhje të mbajtur ku ishin të ftuar organet ekzekutive, ndërkaq asnjë nga anëtarët e ekzekutivit të komunës nuk iu përgjigjën ftesës së këtij komiteti.

2. Rruga "Agim Bajrami" ka mbetur në gjendje të keqe pa u rregulluar, është mirë më përshpejtuar procedurat që kjo rrugë të rregullohet, kur dihet se edhe nga komuniteti kemi pasur shumë kërkesa për gjendjen jo të mirë të kësaj rruge.

3. Çështja e thëngjillit, Ligji është miratuar që mos me u përdorur kjo lëndë djegëse në institucione për nxehje, sepse është e dëmshme për qytetarët e komunës. Sugjeroj mos të përdorët kjo lëndë djegëse, sepse po dëmtohen qytetarët e komunës në njërin anë dhe në anën tjetër po krijohen shpenzime buxhetore për një derivat të dëmshëm.

znj. Hafize Sallahi, Unë në mbledhjen e kaluar e kam bërë një Kërkesë për çështjen e mosfunksionimit të Ambulancës në Ivajë, ndërkaq nuk kam marrë ndonjë përgjigje nga drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në atë kërkesë. Kërkesa ime është bërë jo si Hafize, por në emër të qytetarëve të komuniteteve të asaj pjese, kështu nuk është në rregull mos me marrë përgjigje në kërkesat tona.

z. Shpend Krusha,

1. Pyetja e 1 është e ripërsëritur lidhur me Kërkesën e bërë në emër të Kuvendit të Komunës, drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës për ndërtimin e një kyçje- ç kyçje në Autostradë në afërsi të qytetit të Kaçanikut. Pyetja ime është: A ka ndonjë përgjigje nga Ministria e Infrastrukturës lidhur me kërkesën e KK? Për këtë çështje, kërkoj nga ky kuvend që të formohet një Komision për me shkuar në ministri apo të ftohen zyrtarët kompetent të Ministrisë së Infrastrukturës këtu, për me biseduar për këtë çështje, sepse Kërkesa e KK si duket ka hasur në injorim total nga ana e ministrisë.

2. Kartelat identifikuese neve anëtarëve të KK nuk na janë bërë ende, Kërkesë kjo të cilën e kam ngritur edhe në mbledhjen e kaluar.

3. Kamerat e sigurisë me intereson të di a janë aktive, nëse nuk janë aktive, atëherë ku është arsyeja dhe kush duhet të merret me këtë punë?

Kryesuesi i Kuvendit, Lidhur me shqetësimet që u ngritën nga z. Shpend Krusha për çështjen e Kërkesës të cilën ia kemi bërë Ministrisë së Infrastrukturës për ndërtimin e një kyçje-ç kyçje në Autostradë, iu njoftoj së për kundër kërkesës së KK të cilën kërkesë e hartuam me shefat e grupet parlamentare të KK, nuk kemi ndonjë përgjigje. Ne, për këtë çështje ose do të shkojmë në Ministri ose do t'i ftojmë këtu zyrtarët e ministrisë për me na dhënë shpjegime të nevojshme lidhur me kërkesën tonë. Për kërkesat tjera përgjigjet besoj do t'i merri nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhjen vijuese. Meqë nuk ka kërkesa të tjera, atëherë kalojmë në pikën e radhës:

2. Propozim Rregullorja për Tatimin për pronën e paluajtshme për vitin 2019;

Kryesuesi i Kuvendit, Kjo çështje është shqyrtuar edhe në KPF dhe në atë mbledhje kanë dalë disa kërkesa, por kur është shqyrtuar kjo çështje u vërtetuar se nuk mund të lëvizim në normat tatimore pavarësisht kërkesave. Në këtë pikë sqarime të nevojshme do të jap drejtori i DEFZH, Bahri Selimi.

z. Bahri Selimi, Theksoj se kjo Rregullore po shqyrtohet me vonesë nga vitet tjera që u shqyrtonte krahas buxhetit, për shkak së ka hyrë në fuqi Ligji i ri i Tatimit në pronë dhe do të tatonen jo vetëm objektet, por edhe tokat. Lirime ka të pronat e banimit për 15.000€, e që me Rregulloret e mëhershme ka qenë 10.000€. Pronat industriale dhe komerciale janë të njëjta si kanë qenë, ndërkaq risi është të tatimi i tokës, në vitin 2019 do të tatonet vetëm 20% e vlerës së tatimit të tokës, është ky projekt i Qeverisë së Republikës së Kosovës në bashkëpunim me Qeverinë e Suedisë. Vlerësimet sipas zonave ia kemi bashkangjitur një Raport të vlerësimit nga MEF, në bazë të kriterëve të përcaktuara. Nëse mendohet që dikujt iu ka bërë e padrejtë, është Komisioni i Ankesave që i shqyrton ankesat. Në KPF dhe në rrjetet sociale thuhet se ka komuna që e kanë ulë normën tatimore për 10%, por ata kanë prekur në vlerën e normave të pronave, sepse norma me e ulët tatimore për shtëpi banimi është 15%, ndërkaq nëse Komuna Ferizajt i ka ulë normat tatimore duke prekur në vlerën e normave tatimore, atëherë kjo mbetet në barrë e rëndë për qytetarin edhe pse është më e zhvilluar.

Kryesuesi i Kuvendit, I dëgjua sqarimet e drejtorit, nëse ka kush diçka në këtë draft rregullore e hapi diskutimin:

z. Selim Reka, Kjo draft Rregullore është shqyrtuar edhe në KPF dhe ne kemi kërkuar që nëse Komuna e Ferizajt ka bërë ulje të normave tatimore, të bëhet edhe të ne me këtë Rregullore. Të kriteret, është mirë që ne vet t'i caktojmë kriteret, ashtu që për lagjet që nuk kanë ujësjellës apo kanalizim, pavarësisht zonës ku banon, të ulën normat tatimore. Të kamatat, kujtoj se kamatat duhet me u aplikuar pas përfundimit të vitit e jo siç po aplikohet pas gjashtë muajve, sepse kjo masë po i dëmton qytetarët e komunës e në veçanti mërgimtarët të cilët nuk kanë mundësi me paguar para muajit të gjashtë TP. Edhe për këtë kërkesë në KPF na është thënë se nuk ka mundësi me u zbatuar ndryshe. Unë kërkoj që kjo të rishqyrtohet edhe një herë. Edhe të Vilat, në KPF kemi kërkuar të rriten normat tatimore e jo të tatonen sipas zonës që janë të barabarta me shtëpi banimit.

z. Ekrem Kyçyku, Draft Rregullorja për Tatimin për pronën e paluajtshme shihet se ka vend për përmirësime. Këtë e themi sepse: nëse i analizojmë normat tatimore sipas zonave të banimit, shihet se Zona I-r me Zonën e IV-të kanë shumë dallime. Në këtë rast, nëse marrim shembull f. Shtrazë, shihet se normat tatimore në zonën e IV-të janë të ulëta. Dikush jeton në f. Shtrazë, dhe ka edhe vilë të ndërtuar atje, kështu norma për vilat kujtoj se duhet të jenë më të larta e jo e barabartë me shtëpitë e banimit në të njëjtën zonë. Të normat tatimore të shtëpitë e banimit, Ferizaji e ka aplikuar normën 10%, ndërkaq MAPL nuk ua ka kthyer si të kundërigjshëm Rregulloren e Tatimit në Pronë kësaj komune.

z. Adnan Reka, Me mënyrën se si po veprohet, tatimi në pronë është i padrejtë, sepse; Nga draft rregullorja shohim se Komuna e Kaçanikut është e ndarë në 4 zona tatimore. Pjesa qendrore e qytetit bënë pjesë në Zonën I, pjesa periferike e qytetit dhe Bobi bëjnë pjesë në Zonën II, ndërsa të gjitha fshatrat tjera të Komunës bëjnë pjesë në Zonën III dhe IV. Në bazë

te tabelave që kemi, hisja me e madhe për të paguar i bie Zonës I, pastaj II e kështu me radhe, gjë për të cilën deri këtu, edhe unë pajtohem. Marrë parasysh inkasimin e të hyrave vetanake, Komuna jonë në total planifikon t'i realizojë 694,915 euro, ndërsa vetëm nga tatimi në pronë planifikon t'i realizojë 272.000 euro, që është shuma kryesore, që përafërsisht i bie 40% e të HV të Komunës. Tani, e gjithë kjo shume inkasohet nga tatimi që qytetarët paguajnë për pronat e tyre, (shtëpitë, banesat, tokat apo çfarëdo prone të paluajtshme) Pra, kush paguan pjesën me të madhe nga kjo shumë ? Paguajnë banorët e Komunës që jetojnë në zonën I dhe II, që përbejnë 1/3 e popullsisë së Komunës. Ndërkaq kur të vjen puna e investimeve kapitale apo punësimeve nëpër institucione komunale dhe kompani publike, janë po këta banorë të zonës I dhe II që diskriminohen me së shumti dhe marrin pjesë me se paku në investime kapitale dhe në punësime nëpër institucione komunale apo kompani publike. Dhe lëre që nuk marrin pjesë me 1/3 që do të duhej të ishte, por as me 1/10 apo 1/15 e popullsisë nuk marrin pjesë. Të nderuar këshilltarë, cili është privilegji i të qenit banorë i zonës I dhe II? Taksa me e madhe që paguajnë këta banorë, ajri i helmuar që thithin si pasojë e ndotjes nga thëngjilli që përdor komuna për ngrohje, apo kanalizimi nëpër të cilin duhet të ecin qytetarët e kësaj zone. Kush po krijon ndarje në këtë Komunë? ata që vjelin taksat e qytetarëve dhe bëjnë shpërndarjen e buxhetit nëpër zona të Komunës varësisht nga interesat grupore, klanore e individuale, apo ata që e thonë të vërtetën ashtu siç është. Pra, ata që flasin, apo ata që veprojnë?

z. Nexhat Loku, Nuk është mirë me bërë ndasi se kush po jeton lartë apo poshtë. Me këtë me ke kthyer z. Adnan në kohën e hershme kur u behshin ndasitë, fshat-qytet.

z. Adnan Reka, Në Zonat e banimit nuk i kam ndarë unë, por i ka ndarë ligji, ndarjen po e bënë komuna që nuk po investon e jo unë.

z. Nexhat Loku, Unë mendoj se nuk është në rregull të bëhen diferencime mes fshatrave dhe qytetit, për mua të gjithë qytetarët e Komunës së Kaçanikut janë të barabartë, pavarësisht se ku jeton.

z. Adnan Reka, Unë jam të ketë barazi në ndarje të buxhetit, ashtu që ai komunitet që paguan me tepër taksa, të ketë edhe privilegje; investime, punësime etj.

z. Bekim Koxha, Unë kujtoj se nuk është në rregull me u bërë dallime fshat-qytet në këtë kohë. Kur është fjala se po investohet në fshatra me tepër se në qytet, po ua përkujtoj së në f. Koxhaj ne ende nuk kemi ujë, ndërkaq në qytet ujësjellësi është moti kohë.

z. Adnan Reka, Unë nuk përmenda ndarjet fshat qytet, ndarjet po i bënë pushteti, unë e potencova shpërndarjen e buxhetit nëpër zona të Komunës varësisht nga interesat grupore, klanore e individuale.

Kryesuesi i Kuvendit, Rregullorja është e qartë, edhe unë ndoshta i kam pakënaqësitë e mia në disa raste të caktuara, por janë ligjet që i rregullojnë normat tatimore, kështu që ne duhet të pajtohemi në këtë drejtim.

Kryetari i Komunës- Besim Ilazi, Mendoj së nuk është në rregull me bërë aso krahasime, sepse në për çështjen e Investimeve Kapitale kemi zhvilluar debat publik, ndërkaq nuk qëndrojnë ato që thuhet se nuk po investohet në qytet, kur dihet së, QKMF është ndërtuar në qytet, Halla Sportive në qytet, Çerdhja e Fëmijëve do të ndërtohet në qytet, Shkolla të Kisi në qytet, pastaj investimet që janë bërë në dy shkolla në qytet. Ndriçimi publik në qytet,

kështu nuk është mirë dhe me duket shumë e padrejtë me i bërë këto krahasime, kur dihet se ende kemi shumë rrugë të paasfaltuara në fshatra.

z. Adnan Reka, Kryetar, të gjitha këto investime të cilat i përmende janë prona të përbashkëta për të gjithë qytetarët e Komunës së Kaçanikut. Në Kaçanik të Vjetër ka Ambulancë, pastaj janë dy shkolla. Me tregoni mua, cili është dallimi i të jetuarit në qytet në krahasim me fshatin.

Kryesuesi i Kuvendit, Jemi duke folur për Rregulloren e tatimit në pronë, ndërkaq çështja e investimeve kapitale është në Raportin e realizimit të mjeteve buxhetore.

Kryetari i Komunës, Për mua qytetarët e Komunës së Kaçanikut të gjithë janë të barabartë. Disa investime kapitale- privilegjet shkoj në qytet dhe normal se i takojnë qytetit.

z. Bahri Selimi, Nga viti i ardhshëm mundemi me krijuar nën zona, ndërkaq kamatat i cakton niveli qendror. Nga viti vijues pagesat janë më rata për janar- prill, dhe faza e dytë për prill-shtator. Tani do të bëhen Udhëzime të reja Administrative dhe kanë logjikë propozimet e juaja në pozicionet ku duhet intervenuar dhe do t'i shqyrtojmë. Sa i përket normës tatimore që u potencua 10% e ka Ferizaj për shtëpi të banimit, kujtoj se nuk ka normë tatimore 10%. TP ka lidhje me të mirat të cilat i gëzon biznesi dhe kjo është mundësi e gjenerimit të te HVK.

Kryesuesi i Kuvendit, Për çështjen e tokave, duhet me kërkuar lehtësira, sepse është shumë vështirë me futur në pagesë. Meqë nuk ka diskutime të tjera, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër ishin 6 anëtarë, Abstenim nuk pati. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës, e;

APROVOJ

Rregulloren për Tatimin për Pronën e Paluajtshme për vitin 2019 / Lënda: 01Nr. 05-430/03-36591/18.

3. Raporti Financiar për periudhën: Janar- Shtator 2018;

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse ka kush diçka në Raportin financiar, e hapi diskutimin:

z. Ekrem Kyçyku, Buxheti i alokuar me atë të shpenzuar dallon shumë, sepse alokimi është më i madhë, në raport me mjetet e shpenzuara. Një vërejtje të cilën e kam pasur në KPF, shihet se është reregulluar, kështu unë nuk kam diçka tjetër.

z. Selim Reka, Unë kam vërejtje të te HVK, sepse parashikohen me Plan me shumë mjete buxhetore, ndërkaq nuk inkasohen mbi 400.000€. Nëse i shikojmë të HVK sipas sektorëve, shihet se 0 janë të hyrat nga inspektorati njëjtë është edhe nga masa drusore. Nëse i analizojmë shpenzimet, shihet se për investime kapitale për 9 muaj janë shpenzuar 41% e tyre, ndërkaq të M\$ SH, në disa pozicione ,si të: derivatet, riparimi i automjeteve janë shpenzimet me të mëdha.

z. Shpend Krusha, Shpenzimet komunale nga Raporti financiar, shihet se kanë shënuar ndryshime, si të energjia elektrike, të uji kemi ngritje për 54%, ndërkaq të telefonja kemi ngritje për 211%. Pse janë këto ngritje kaq të mëdha.

z. Bahri Selimi, Jep sqarime të nevojshme lidhur me pyetjet të cilat u ngritën; Realizimi i të HVK është i vogël, ndërkaq kemi marrë veprime të nevojshme që ato të ngritën. Raporti është për 9 muaj, kështu ende ka kohë për inkasim të mjeteve. Të IK procedurat janë kështu, kështu që marrin kohë, përndryshe edhe trendi me i madh është për gjatë periudhës. Të pozicioni, Mallra dhe Shërbime, derivatet dhe mirëmbajtja e veturave kanë shënuar ngritje. Të mirëmbajtja e veturave, dihet se komuna ka vetura të vjetra dhe këto kërkojnë mirëmbajtje, ndërkaq të derivatet janë rritur shpenzimet sepse po shtohet numri i objekteve publike.

Kryesuesi i Kuvendit, Meqë nuk ka kush diçka tjetër, atëherë konfirmoj se Kuvendi i Komunës u,

NJOFTUA

Me Raportin Financiar për periudhën: Janar- Shtator 2018/ Lënda: 01Nr. 05-400/01-37732/18.

4. Propozim Vendimi për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal;

Kryesuesi i Kuvendit, Për sqarime të nevojshme në këtë pikë, fjalën e ka drejtori i DUKMM, Ukshin Qallaku.

z. Ukshin Qallaku, Me herët Kuvendi i Komunës ka marrë Vendim për Revidimin e PZHK, kështu ministria na ka sugjeruar hartimin e PZHK.

PZHK, ka vend për me u ndryshuar, sepse ne e dimë se ndërtimi i autostradës e ka ndryshuar gjendjen e PZHK. Probleme na kanë shkaktuar edhe ndërrimet e destinimeve, sepse nga viti 1998 shumë prona që kanë qenë ndërtimore janë bujqësore. Kështu dihet se kemi pasur probleme në zbatim të PZHK. Për hartimin e këtij Plani, shumicën e punëve do t'i kryejmë vet, ndërkaq do të angazhojmë edhe staf nga jashtë - ekspertë të lëmit përkatëse. Nëse kalon PZHK në Kuvend, atëherë Kryetari i Komunës do të zgjedhë një kordinator dhe kanë me u zhvilluar debate publike nëpër komunitete.

Kryesuesi i Kuvendit, I dëgjuat sqarimet e drejtorit të DUKMM, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin;

z. Selim Reka, Nevoja është me u hartuar PZHK. Kur të hartohet ky Plan, është mirë të bëhet nga ekspertë të jashtëm dhe të brendshëm, për kundër asaj që ka reflektime buxhetore të bëhet një plan i mirë dhe i qëndrueshëm.

Kryesuesi i Kuvendit, Duhet me pasur kujdes ata që punojnë në hartimin e këtij plani, sepse për 8 vite mbetet PZHK i cili do të aprovohet, kështu duhet të bëhet një Plan i mirë dhe i qëndrueshëm.

z. Ekrem Kyçyku, Edhe unë kërkoj që Komuna t'i shqyrtoj të gjitha mundësitë që të bëhet një Plan Zhvillimor Komunal i mirë dhe i qëndrueshëm, në mënyrë që mos të kemi probleme në zbatimin e tij në të ardhmen.

z. Bekim Koxha, Edhe unë mendoj se duhet të bëhet një Plan Zhvillimor Komunal i mirë dhe i qëndrueshëm, nga njerëz ekspertë të fushave përkatëse. Në atë Plan duhet të hyjnë

edhe Zonat turistike dhe ato të biznesit, ashtu që të bëhet një Plan i mirë i zhvillimit komunal, ashtu si i ka hije.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, kështu këtë Propozim Vendim e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Hartimin e Planit Zhvillimor të Komunës së Kaçanikut / Lënda: 01Nr. 104/02-34740/18.

6. Plani lokal i veprimit për persona me aftësi të kufizuara në Komunën e Kaçanikut, 2019-2021;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, besoj është dashur të jetë dikush nga DSHMS për me arsyetuar këtë Plan. Për arsyetime nëse mundem më ia dhënë fjalën, Artan Mëzraja nëse ka nevojë edhe pse nuk kemi të drejtë me ia dhënë fjalën personave të tjerë, pos atyre të përcaktuar me Rregullore për punë të kuvendit, por po bëjmë përjashtime, pasi i njëjti ka qenë në rrjedha të hartimit të këtij plani. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

znj. Lirije Luta, Unë jam e kënaqur që kam qenë e përfshirë me dhënë kontributin në hartimin e këtij drafti. E falënderoj OJQ dhe çdo kush tjetër që ka dhënë kontributin e tij në këtë Plan. Unë çdo herë kur të jetë nevoja për çështjen e personave me aftësi të kufizuara do të jap kontributin tim.

z. Bekim Koxha, Edhe ne subjekti politik NISMA kemi qenë aktiv në çështjen e përpilimit të këtij Plani, kështu i japim mbështetjen të kalon ky plan miratimin e tij nga KK.

z. Ekrem Kyçyku, Edhe LVV i japim mbështetje këtij Plani të veprimit. Vërejtjet tona që i kemi pasur, shihet se janë marrë parasysh, kështu që e mbështetim.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë Plan të veprimit e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Aprovimin e Planit lokal të veprimit për persona me aftësi të kufizuara në Komunën e Kaçanikut për vitet, 2019-2021 / Lënda: 01Nr. 104/02-34843/18.

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, kështu në ora: 12:12 Kryesuesi i Kuvendit e konstatoj mbledhjen të përfunduar. Deri në fund të mbledhjes qëndruan 26 anëtarë, ndërkaq pak para se më përfunduar mbledhja, me arsye doli, Besnik Salihu.

Procesmbajtës
Makfere Malsiu
Makfere Malsiu

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli
Kemal Mërseli



REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS
(të zgjedhur në votimet e datës 22 Tetor 2017);

nga Mbledhja e XI (Njëmbëdhjetë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës
për vitin 2018, mbajtur me 29 Nëntor 2018.

1. Kemal Mërseli.....,
2. Hamid Guri.....,
3. Ahmet Luma
4. Kadri Krivenjeva.....,
5. Besim Vishi.....,
6. Sali Malsiu.....,
7. Lirije Shurdhani.....,
8. Pranverë Loku- Zharku.....,
9. Lirije Luta.....,
10. Vlora Dalloshi.....,
11. Nexhat Loku
12. Shpend Krusha.....,
13. Adnan Reka.....,
14. Ekrem Kyçyku.....,
15. Fatijona Kyçyku.....,
16. Kaltrina Tafili
17. Selim Reka.....,
18. Besnik Salihu.....,
19. Nazife Krasniqi.....,
20. Arlinda Rakoci-Raka.....,
21. Shemsedin Luzha.....,
22. Albana Troni.....,
23. Afërdita Shehi.....,
24. Hajredin Luta.....,
25. Hafize Sallahi
26. Bekim Koxha.....,
27. Ekrem Raka.....,